



**Në bazë të nenit 11 të Statutit të Kolegjit "Biznesi" në Prishtinë,  
Këshilli i Lartë Mësimor-Shkencor i Kolegjit "Biznesi" më 14. 11.  
2019 miratoi këtë:**

## **RREGULLORE**

### **PËR PUNË KËRKIMORE-SHKENCORE NË KOLEGJIN "BIZNESI"**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohet statusi, aktivitetet, struktura, qeverisja dhe procesi i vendim-marrjes në fushën kërkimore-shkencore.

#### **Neni 2**

Në Kolegjin "Biznesi" do të themelohet një rrjet i entiteteve hulumtuese në kuadër të Kolegjit dhe të secilit departament.

2.1. Forma themelore në kuadër të Kolegjit "Biznesi" për kryerjen e aktiviteteve hulumtuese-shkencore është Instituti për Hulumtime Shkencore e Kolegji "Biznesi".

2.2. Formë themelore institucionale e kryerjes së aktiviteteve hulumtuese në kuadër të Kolegjit "Biznesi" është Instituti për hulumtime shkencore.

2.3. Instituti për Hulumtime Shkencore do të ketë njësitë e veta hulumtuese-shkencore dhe botuese. Ajo do të menaxhohet nga drejtori i Institutit për Hulumtime Shkencore i Kolegjit "Biznesi". Drejtori i Institutit i raporton drejtpërdrejt strukturave menaxhuese dhe akademike të Kolegjit "Biznesi".

2.4. E tërë veprimtaria hulumtuese-shkencore dhe botuese ka të bëjë me lëmit shkencore që janë objekt studimi në Kolegji "Biznesi".

#### **Neni 3**

Në Kolegji "Biznesi" do të themelohen këto entitete apo njësi hulumtuese:

- a. Sektori për hulumtime shkencore Ekonomike-Juridike;
- b. Sektori për trajnime dhe zhvillim të stafit akademik.

#### **Neni 4**

Këto njësi hulumtuese do të koordinohen nga drejtori i Institutit, në mbikëqyrjen e përgjegjësve të tyre.

#### **Neni 5**

Njësité hulumtuese do të jenë pjesë e Kolegji “Biznesi”, respektivisht të Institutit të udhëhequra nga drejtori i Institutit, ndërkaq të menaxhuara nga përgjegjësit e tyre.

### **Neni 6**

Proporcioni financiar nga projektet e realizuara do të përcaktohet sipas Statutit të Kolegji “Biznesi” 50 % për Kolegjin, 20 % për zhvillimin e stafit të Kolegjit, dhe 30% për personat e përfshirë në implementimin e projektit.

Deri në fillimin e punës së njësive hulumtuese shpenzimet e punës së tyre do të mbulohen nga buxheti i Kolegji “Biznesi” për hulumtime shkencore.

### **Neni 7**

Njësité hulumtuese janë pjesë e Kolegjit dhe nuk janë njësi të ndara ligjore kështu që ato nuk do të kenë mjetet e veta financiare, të ndara nga Kolegji “Biznesi”, pra llogari bankare.

### **Neni 8**

Dy herë në vit (një herë në çdo semestër), në nivel të Kolegjit, stafi i Institutit për hulumtime shkencore do të mbajë mbledhje ku do të shqyrtohen aktivitetet individuale hulumtuese të çdo anëtari të stafit, si edhe projektet e punës kërkimore-shkencore nëpër departamentet përkatëse.

### **Neni 9**

9.1. Njësité hulumtuese do të themelohen me vendimet e Këshillit të lartë mësimor-shkencor të Kolegji “Biznesi” të fuqizuara nga dekani i Kolegji “Biznesi”.

9.2. Çdo njësi hulumtuese do të nxjerrë udhëzime të hollësishme procedurale lidhur me organizimin, strukturën dhe funksionimin e saj.

### **Neni 10**

Të gjitha vendimet e Kolegji “Biznesi”, lidhur me themelimin dhe emërimet e Njësive hulumtuese do të aprovohen nga Këshilli i lartë mësimor-shkencor i Kolegji “Biznesi”.

### **Neni 11**

11.1. Në nivel të Kolegji “Biznesi” do të themelohet Komiteti Këshillëdhënës i Kolegjit për punë kërkimore-shkencore.

11.2. Ky Komitet do të udhëhiqet nga prodekani për punë kërkimore-shkencore dhe do të:

- aprovojë planin vjetor të Kolegji “Biznesi” për punë kërkimore-shkencore;
- shqyrtojë aktivitetet e propozuara hulumtuese të çdo departamenti;
- shqyrtojë të arriturat individuale hulumtuese të stafit të Kolegjit.

### **Neni 12**

*12.1.* Ky komitet do të takohet tri herë në vit e sipas nevojës edhe me shpesh.

### **Neni 13**

Në mbledhjen e Komitetit të Kolegjit për punë kërkimore-shkencore çdo përgjegjës i departamentit do të prezantojë planin vjetor për punë kërkimore-shkencore, aktivitetet lidhur me projektet konkrete hulumtuese dhe planet e ardhshme për vitin vijues akademik.

### **Neni 14**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

---

Dekan